



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR

TIRANË

Nr. 1317/1585 Akti Nr. 1156  
Vendimi  
Data e regjistrimit 09.03.2022/14.04.2022 Data e vendimit  
27.04.2022

**V E N D I M**  
**"NË EMËR TË REPUBLIKËS"**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë prej:

**Gjyqtare –Armela HASANTARI (K/seance)**

**Gjyqtar -Albert MEÇA (Anetar)**

**Gjyqtar - Artan GJERMËNI (Anetar)**

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Berzana Çobo**, sot më datë 27.04.2022, pasi mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike çështjen penale Nr. **1317/1585** Regjistri Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:**Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar nga Prokurori **Enklid Gjini**.

**I PANDEHUR:****Kreshnik Halilaj**, i biri i Fatmirit dhe Dritës, i dtl. 27.08.1981, lindur dhe banues në Tiranë, rruga “Halit Bega”, Alias, i padënuar më parë, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, i martuar me dy fëmijë të mitur, me arsim të mesëm, mbrojtur me deklaram në seancë gjyqësore nga Av. Elton Hyseni, me nr. 2790 Liçence dhe NIPT K01404048A, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë.

**AKUZUAR:**Për kryerjen e veprës penale të “**Prodhimi dhe shitja e narkotikëve**”, parashikuar nga neni **283/2** i Kodit Penal.

Në përfundim të gjykimit zhvilluar në prani të përfaqësuesit të Prokurorisë Enklid Gjini, në prani të të pandehurit Kreshnik Halilaj, në prani të mbrojtësit të tij Av. Elton Hyseni, Gjykata pasi dëgjoi në fazën e konkluzioneve përfundimtare palët, të cilat kërkuan:

**Prokurori:** Deklarimin fajtor të të pandehurit Kreshnik Halilaj, për veprën penale të “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite, dënimin e tij me 7 (shtatë) vjet burgim. Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, kërkoi

dënimin e të pandehurit Kreshnik Halilaj me 4 (katër) vjet e 8 (tetë) muaj burgim. Shpenzimet proceduriale të lihen në ngarkim të të pandehurit.

**Mbrojtësi i të pandehurit:** Kërkojmë që Gjykata për të pandehurin Kreshnik Halilaj të vendosi, për shkak të rrezikshmërisë së pakët të personit dhe rrethanave të tjera lehtësuese që përmendëm më sipër, ta dënojë këtë shtetas në minimumin e dispozitës të parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal. Për shkak të rrezikshmërisë së pakët të personit dhe rrethanave të tjera lehtësuese që përmendëm më sipër, për pjesën e dënimit të mbetur pa vuajtur me burg, Gjykata të vendosë të pezullojë ekzekutimin e dënimit me burgim për këtë të pandehur dhe të aplikojë nenin 59 të Kodit Penal duke e vënë këtë të pandehur në provë pasi ekzistojnë kushtet e parashikuara nga ky nen.

**I pandehuri Kreshnik Halilaj:** Dakord me mbrojtësin. Jam shumë i penduar.

### VËREN:

#### I **Rrethanat e faktit.**

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, në datë 09.03.2022, depozitoji në Gjykatë, kërkesën penale me objekt “*Dërgimin në gjyq të çështjes penale, me të pandehur Kreshnik Halilaj, i biri i Fatmir dhe Drita, i datëlindjes 27.08.1981, lindur në Tiranë, i akuzuar se ka kryer veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal*”. Me shortin e datës 09.03.2022, kjo kërkesë i kaloi për shqyrtim këtij trupi gjykues. Në zbatim të neneve 332 e vijues të K.Pr.Penale, nga ana e Gjykatës u caktua seanca paraprake, duke u njoftuar prokuroria dhe i pandehuri. Në seancën e datës 14.04.2022, Gjykata pasi verifikoi paraqitjen e palëve, në zbatim të nenit 332/c të K.Pr.Penale, deklaroi të hapur shqyrtimin gjyqësor. Pas parashtrimit të kërkesës dhe provave nga prokurori, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij paraqitën kërkesën për të proceduar me gjykim të shkurtuar.

2. Nisur nga kërkesa për gjykim të shkurtuar e paraqitur nga i pandehuri Kreshnik Halilaj, në seancë paraprake, Gjykata iu referua parashikimeve të nenit 332/dh, pika 1, gërma c) të K.Pr.Penale, e cila nën titullin “*Vendimi i gjyqtarit të seancës paraprake*”, ndryshuar shkronja “b” dhe “c”, shtuar shkronja “d” e pikës 1 me ligjin nr. 41/2021, datë 23.3.2021, parashikon se: “*1. Pasi dëgjon diskutimet e palëve, gjykata vendos: c) të ftojë palët të paraqesin diskutimet përfundimtare kur i pandehuri ka kërkuar gjykimin e shkurtuar, pasi kryen verifikimin mbi gjëndjen e akteve, sipas parashikimeve të nenit 332/c të këtij Kodi. Palët kanë të drejtë të kërkojnë një afat për t’u përgatitur, jo më të gjatë se 15 ditë...*”. Gjykata vlerëson se me ndryshimet që iu bënë K.Pr.Penale, me Ligjin Nr. 41/2021, datë 23.03.2021, nëse kërkesa për gjykim të shkurtuar paraqitet në seancë paraprake, ajo nuk mund të refuzohet për asnjë arsye. Ajo në çdo rast duhet pranuar, me kushtin që Gjykata të marrë në shqyrtim dhe të vlerësojë kërkesat e palëve për pavlefshmërinë e akteve të hetimeve paraprake, papërdorshmërinë e provave, nevojën për marrjen e provave të tjera, si dhe kërkesën e të pandehurit për të dhënë deklarime ose të kërkojë të pyetet. Me marrjen e kërkesës për të proceduar me gjykim të shkurtuar dhe verifikimit të gjëndjes së akteve, Gjykata fton palët në bisedimet përfundimtare, duke iu dhënë atyre kohën e nevojshme për ti përgatitur, por jo më gjatë se 15 ditë.

3. Në rastin konkret, Gjykata nuk konstatoi pengesa nga ato të parashikuara nga neni 332/c i K.Pr.Penale dhe për këtë arsye vendosi ta pranojë kërkesën e të pandehurit Kreshnik Halilaj, për të proceduar me gjykim të shkurtuar. Gjykata vlerëson se çështja penale në ngarkim të të pandehurit dhe akuza e ngritur ndaj tij, nuk do të jetë më në kuadrin e provave të mjaftueshme për dërgimin e çështjes për gjykim, por do të jetë në kuadrin e provimit të akuzave ndaj tyre tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Në kushtet e procedimit me gjykim të shkurtuar, duke prezumuar pranimin nga palët e të gjitha akteve dhe provave të grumbulluara në fazën e hetimeve paraprake dhe duke i vlerësuar ato në tërësinë e tyre çmon të provuar faktin si më poshtë:

3.1 Seksioni për Hetimin e Narkotikëve në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë ka patur të dhëna të marra në rrugë operative ligjore se shtetasi Kreshnik Halilaj merret me shitje të lëndëve narkotike të llojit kokainë, heroinë dhe cannabis sativa. Sipas informacioneve, shtetasi Kreshnik Halilaj, të cilin e thërrasin “Nik Xhuxhi” tregëton kryesisht lëndën narkotike kokainë, të ndarë në doza, në zonen e Oxhakut dhe të Kinostudios, Tiranë, por merret dhe me shitje të lëndës narkotike heroinë dhe cannabis sativa. Ky shtetas lëndën narkotike të llojit kokainë e shet në shumën e 10,000 lekëve për gram. Shtetasi Kreshnik Halilaj lëndën narkotike të llojit kokainë dhe heroinë, e mban të ndarë në qese të vogla në ambjentet e dyqanit të tij me emër “Tabacchino Ansel”, që ndodhet në rrugën “Halit Bega”, Allias, Tiranë. Sipas informacioneve që disponoheshin nga ana e punonjësve të policisë, shtetasi Kreshnik Halilaj lëndën narkotike e mban të fshehur në një pallat dy katësh me tulla të bardha, i cili është ngjitur me banesën e një shtetaseje që quhet Linda. Përdoruesit e lëndës narkotike të llojit kokainë, i dërgojnë mesazh shtetasit Kreshnik Halilaj, që duan ta takojnë, ndërkohe ai bën gati lëndën narkotike. Shtetasi Kreshnik Halilaj ka punësuar dhe persona të tjerë kundrejt pageses, kryesisht djem të rinj, të cilët bëjnë shpërndarjen e lëndës narkotike me motorra. Shtetasi Kreshnik Halilaj ka në posedim një motor të markës “Yamaha”, me targë AN400 dhe një automjet tip autoveture të markës “AUDI”, model A3 me targa AA479RR.

3.1.1 Me qëllim të dokumentimit të plotë ligjor të këtij aktiviteti kriminal është vendosur përdorimi i metodave speciale të hetimit, si autorizim për vezhgim, blerje të stimuluar, filmim fotografim, interceptim për numrat e telefonit, si dhe autorizim për kontroll lokal dhe banese.

3.2 Në bazë të autorizimit për lejimin e vëzhgimit dhe përgjimit të fshehtë ambiental audio dhe video në vende publike, të datës 01.05.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, në funksion të procedimit penal Nr. 3063, të vitit 2021, shërbimet e policisë në datë 04.05.2021, rreth orës 21:00 kanë qene të vendosur në rrugën “Halit Bega”, Tiranë, ku kanë konstatuar shtetasin Kreshnik Halilaj në dyqanin e tij “Tabacchino Ansel”. Rreth orës 21:40 të kesaj date, nga ana e punonjësve të policisë, është konstatuar një person me motor me targë CAD 542, i cili ka ndaluar përpara tabachinos së shtetasit Kreshnik Halilaj, është takuar me shtetasin Kreshnik Halilaj, kanë biseduar pak dhe më pas kanë shkëmbyer dicka. Më pas personi me motor ka vazhduar lëvizjen sipas sensit të rrugës “Halit Bega”, duke u afruar drejt vendit ku kanë qene të vendosura shërbimet e policisë, të cilat i kanë bërë shenjë ndalimi, i janë prezantuar si punonjës policie dhe më pas ky person është identifikuar si shtetasi Artur Nela. Në momentin që ka ndaluar motorrin, shtetasi Artur Nela mbante në dorën e majtë një qese të vogël transparente, e cila ka qënë e spërdredhur dhe e djegur nga njëra ane brenda së cilës, ka patur një sasi lënde të bardhë të dyshuar lëndë narkotike e llojit kokainë. Pasi është bërë sekuestrimi i lëndës së dyshuar narkotike e llojit kokainë ka rezultuar me peshë të përgjithshme 0.2 (zero pikë dy) gramë, e cila pas peshimit është futur në qesen e provave me Nr Unik A20004498.

3.2.1 Eshte pyetur në cilesinë e personit nën hetim shtetasi Artur Nela, i cili ka deklaruar se ka shkuar me motor në zonen e Alliasit në rrugën “Halit Bega”, Tiranë, ku ka takuar shtetasin

Kreshnik Halilaj tek tabachinoja përpara shtëpisë së tij. Ai i ka thënë shtetasit Kreshnik Halilaj se “ me duhet një gjysem” dhe i ka dhënë 3500 lekë të reja, i cili pasi ka marrë një dozë me lëndë narkotike kokaine nga dera pas tabachinos ia ka dhënë atij mbi banak të tabachinos. Ai ka deklaruar se shtetasin Kreshnik Halilaj e ka takuar për herë të parë përpara 1 viti, ku i ka thënë se i duhej një dozë kokaine. Kreshniku e ka pyetur se ku rrinte me shtëpi dhe pasi ka krijuar besim se nuk është i policisë, i ka dhënë një dozë me lëndë narkotike të llojit kokainë. Me tej ai ka sqaruar se ka shkuar dhe herë të tjera, për të blerë lëndë narkotike tek shtetasi Kreshnik Halilaj. Gjatë deklarimit ai ka pohuar se për herë të fundit ka pirë kokainë përpara rreth 1-2 jave, por si datë nuk e ka fiksuar.

Shtetasi Artur Nela ka deklaruar se nuk e disponon numrin e celularit të shtetasit Kreshnik Halilaj dhe se kur dëshironte për të blerë lëndë narkotike, ka shkuar tek tabachinoja që ka përpara shtëpisë, e ka takuar, i ka dhënë lekët dhe më pas Kreshniku i ka dhënë dozën. Sipas shpjegimeve të shtetasit Artur Nela, shtetasi Kreshnik Halilaj lëndën narkotike të llojit kokaine e shet në shumën e 7000 lekëve grami dhe pastaj përpjestohet shuma, në varesi të peshës që ka doza e lëndës narkotike.

3.2.2 Në lidhje me këtë ngjarje janë kryer të gjitha veprimet procedurale, si dhe janë përpiluar të gjitha vendimet e ekspertimit përkatës dhe janë administruar aktet e ekspertimit si mëposhtme:

3.2.3 Është administruar **Akti i ekspertimit kimik Nr.5855, datë 17.06.2021, në ngarkim të shtetasit Artur Nela, ku është arritur në konkluzionin se:** *“Analiza me GC/MS për pluhurin objekt ekspertimi tregoi për praninë e kokainës. Peshë pa ambalazh e materialit objekt ekspertimi është 0.255 gramë”*.

3.2.4 Sipas **Aktit të ekspertimit toksikologjiko-ligjor nr.1050, datë 11.05.2021, është arritur në konkluzionin se:** *“Në mostrën e urinës të marrë shtetasit Artur Nela, mbyllur në kontenier dhe të futur në qese prove me Nr.A20004499, nuk u zbulua prania e produkteve të metabolizmit të kokainës ( benzoilekgoninë) në organizmin e njeriut”*.

3.3 Në bazë të autorizimit për lejimin e vëzhgimit dhe përgjimit të fshehtë ambiental audio dhe video në vende publike të datës 01.05.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, në funksion të procedimit penal Nr. 3063, të vitit 2021, shërbimet e policisë në datë 11.05.2021, rreth orës 22:00, kanë qënë të vendosura në rrugën “Halit Bega”, Tiranë pranë dyqanit të shtetasit Kreshnik Halilaj “Tabacchino Ansel”. Pak minuta më vonë pranë tabachinos është afruar një shtetas, i cili ka qëndruar për rreth 40-50 minuta përpara tabacchinos. Rreth orës 23:00 ka mbërritur shtetasi Kreshnik Halilaj me një automjet Smart me ngjyrë të bardhë, i cili ka parkuar makinën pranë shtëpisë dhe është takuar me personin që e priste dhe pasi është futur me tabachino, ai ka dalë pas pak çastesh dhe pasi ka shkëmbyer dicka me këtë person ata janë ndarë. Personi që është takuar me shtetasin Kreshnik Halilaj, ka vazhduar lëvizjen duke ecur gjatë gjithë kohës me duar në xhepa sipas sensit të lëvizjes të rrugës “Halit Bega”, duke iu afruar vendndodhjes, ku ishin vendosur punonjësit e policisë. Pasi është afruar drejt punonjësve të policisë, ata i kanë bërë me shenjë ndalimi, i janë prezantuar, si punonjës policie dhe personi është identifikuar si shtetasi Igli Hida. Në momentin që e kanë ndaluar punonjësit e policisë kanë ushtruar kontroll ndaj shtetasit Igli Hida dhe gjatë kontrollit i kanë gjetur në xhepin e xhinseve që mbante veshur, një qese të vogël transparente, e cila ka qënë e spërdredhur dhe e djegur nga njëra anë brenda së cilës ka patur një sasi lënde material pluhur me ngjyrë të bardhë të dyshuar lëndë narkotike kokainë.

3.3.1 Pasi është bërë sekuestrimi i lëndës së dyshuar narkotike e llojit kokainë, është bërë peshimi i saj dhe ka rezultuar me peshë të përgjithshme 0.4 ( zero pike katër ) gramë, e cila pas peshimit është futur në qesen e provave me Nr Unik B20002134.

3.3.2 Është pyetur në cilësinë e personit nën hetim shtetasi Igli Hida, i cili ka deklaruar se më datë 11.05.2021, rreth orës 22:00, ka shkuar tek banesa e shtetasit Kreshnik Halilaj, të cilit i thërrasin “Nik Xhuxhi”, për të marrë një dozë lëndë narkotike kokainë për ta pirë vetë pasi është përdorues i saj prej rreth 1 viti. Sic ka treguar shtetasi Igli Hida, ai ka shkuar aty, ka takuar babain e Kreshnikut, të cilit i ka thënë se ku është “Niku” dhe ky i fundit i ka thënë se ka dalë dhe se kthehet për gjysëm ore. Ka pritur rreth 40-50 minuta shtetasin Kreshnik Halilaj te lagjia e tij ku më pas ai ka mbërritur me një makine tip Smart të bardhë. Pasi ka takuar shtetasin Kreshnik Halilaj tek tabachino e tij, Kreshniku është futur në banesë. Në keto momente ai e ka pritur jashtë para tabachinos dhe pas pak castesh ka dalë nga banesa Kreshniku dhe ka takuar Iglin. Shtetasi Igli Hida ka pohuar se i ka dhënë 3500 lekë të reja Kreshnikut dhe ky i fundit ka nxjerrë nga goja dozën me lëndë narkotike kokainë dhe ia ka dhënë në dorë Iglit. Shtetasi Igli Hida ka deklaruar se ka qënë edhe disa herë të tjera tek shtetasi Kreshnik Halilaj, ku ka blerë lëndë narkotike të llojit kokainë. Gjatë deklarimit ai ka pohur se për herë të fundit ka pirë kokainë përpara rreth disa ditëve, por si datë nuk e ka fiksuar. Në vazhdim ai ka deklaruar se nuk e disponon numrin e celularit të shtetasit Kreshnik Halilaj dhe se kur dëshironte për të blerë lëndë narkotike, ka shkuar tek tabachinoja që ka përpara shtëpisë, e ka takuar aty, i ka dhënë lekët dhe më pas Kreshniku i ka dhënë dozën. Ai ka treguar se lëndën narkotike shtetasi Kreshnik Halilaj e shet në shumën e 7000 lekëve grami dhe pastaj përpjestohet shuma, në varësi të peshës që ka doza e lëndës narkotike.

3.3.3 Në lidhje me këtë ngjarje janë kryer të gjitha veprimet proceduriale, si dhe janë përpiluar të gjitha vendimet e ekspertimit përkatës dhe janë administruar aktet e ekspertimit si më poshtë:

3.3.4 Është administruar **Akti i ekspertimit kimik Nr.5466, date e09.06.2021, në ngarkim të shtetasit Igli Hida, ku është arritur në konkluzionin se:** *“Analiza me GC/MS për materialin objekt ekspertimi tregoi për praninë e kokainës. Pësia pa ambalazh e materialit objekt ekspertimi është 0.329 grameë”*.

3.3.5 Sipas **Aktit të ekspertimit toksikologjiko-ligjor nr.1142, datë 24.05.2021, është arritur në konkluzionin se:** *“Në mostrën e urinës të marrë shtetasit Igli Hida, mbyllur në kontenier dhe të futur në qese prove me Nr B20001979, nuk u zbulua prania e produkteve të metabolizmit të kokainës (benzoilekgoninë) në organizmin e njeriut”*.

3.4 Në bazë të autorizimit për lejimin e vëzhgimit dhe përgjimit të fshehtë ambientale audio dhe video në vende publike të datës 01.05.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, në funksion të procedimit penal Nr.3063, të vitit 2021, shërbimet e policisë në datë 09.06.2021, rreth orës 22:00, kanë qënë të vendosura në rrugën “Halit Bega”, Tiranë pranë dyqanit të shtetasit Kreshnik Halilaj “Tabacchino Ansel”, ku kanë konstatuar shtetasin Kreshnik Halilaj në dyqanin e tij. Më pas rreth orës 22:30, është konstatuar një person trup i shkurtër me bluzë të zezë, me pak mjekër, i cili ka ndaluar tek tabachinoja e shtetasit Kreshnik Halilaj, e ka takuar Kreshnikun, kanë biseduar pak dhe më pas kanë shkëmbyer dicka. Pasi kanë shkëmbyer dicka, personi ka vazhduar lëvizjen në këmbë, duke u larguar nga tabachinoja dhe njëkohësisht është ndjekur nga shërbimet e policisë të cilët në rrugën “Tasim Shehu”, në vendin e quajtur tek rruga e Komunales, e kanë ndaluar personin, i cili u takua me shtetasin Kreshnik Halilaj, i janë identifikuar si policia dhe personi në atë moment ka lëshuar në tokë një qese transparente, e cila kishte një ngjyrë si në të gjelbërt e mbyllur me spërdredhje me material pluhur me ngjyrë të bardhë të dyshuar si lëndë narkotike kokainë. Është pyetur në lidhje me gjeneralitetet ky person i cili është identifikuar si shtetasi Mariglen Mejdani. Pasi është bërë sekuestrimi i lëndës së dyshuar narkotike të llojit kokainë, është bërë peshimi i saj dhe ka

rezultuar me peshë të përgjithshme 0.4 gramë, e cila është futur në qesen e provave me Nr Unik B20002154.

3.4.1 Është pyetur në cilësinë e personit nën hetim shtetasi Mariglen Mejdani, i cili ka deklaruar se më datë 09.06.2021, rreth orës 22:30, ka shkuar tek banesa e shtetasit Kreshnik Halilaj, të cilin e thërrasin “Nik Xhuxhi”, për të marrë një dozë lëndë narkotike kokainë për ta pirë, pasi është përdorues i saj prej rreth 4-5 muajsh. Pasi ka shkuar tek tabachinoja që ndodhet para banesës së shtetasit Kreshnik Halilaj, ka takuar Kreshnikun, i ka dhënë 3500 lekë të reja dhe ai i ka dhënë një dozë kokainë, të cilën e ka marrë në dorë dhe po shkonte ta pinte. Gjatë rrugës është ndaluar nga punonjësit e policisë dhe në këtë moment ai e ka lëshuar në tokë dozën e kokainës që bleu tek “Nik Xhuxhi”. Më tej ai ka sqaruar se, me shtetasin Kreshnik Halilaj njihet pasi banon në një lagje, nuk ka lidhje miqësore apo familjare dhe se tek Kreshiku ka blerë dhe herë të tjera lëndë narkotike të llojit kokainë, pasi është përdorues i kësaj lënde narkotike prej disa muajsh. Gjatë deklaramit ai ka pohur se për herë të fundit ka pirë kokainë përpara disa ditëve, por si datë nuk e ka të fiksuar. Shtetasi Mariglen Mejdani ka deklaruar se nuk e disponon numrin e celularit të shtetasit Kreshnik Halilaj dhe se kur ka dëshiruar për të blerë lëndë narkotike, ka shkuar tek tabachinoja që ka përpara shtëpisë, e ka takuar, i ka dhënë lekët dhe më pas Kreshniku i ka dhënë dozën. Ai ka sqaruar se lëndën narkotike shtetasi Kreshnik Halilaj e shet në shumën e 7000 lekëve grami dhe pastaj përpjestohet shuma, në varësi të peshës që ka doza e lëndës narkotike.

3.4.2 Në lidhje me këtë ngjarje janë kryer të gjitha veprimet proceduriale, si dhe janë përpiluar të gjitha vendimet e ekspertimit përkatës dhe janë administruar aktet e ekspertimit si më poshtë:

3.4.3 **Është administruar Akti i ekspertimit kimik Nr.6243, datë 25.06.2021, në ngarkim të shtetasit Mariglen Mejdani , ku është arritur në konkluzionin se:** *“Analiza me GC/MS për materialin objekt ekspertimi tregoi për praninë e kokainës. Pësha pa ambalazh e materialit objekt ekspertimi është 0.425 gramë”.*

3.4.4 **Sipas Aktit të ekspertimit toksikologjiko-ligjor nr.1456, datë 21.06.2021, është arritur në konkluzionin se:** *“Në mostrën e urinës të marrë shtetasit Mariglen Mejdani, mbyllur në kontenier dhe të futur në qese prove me Nr B20002155, u zbulua prania e produkteve të metabolizmit të kokainës (benzoilekgoninë) në organizmin e njeriut”.*

4. Në funksion të procedimit penal Nr. 3063, të vitit 2021, në datë 05.07.2021, nga ana e shërbimeve të policisë është ekzekutuar Vendimi penal Nr.1091, datë 04.07.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë , i cila kishte vendosur masën e sigurimit personal Arrest në burg, ndaj shtetasit Kreshnik Halilaj , pasi dyshohet se ka kryer veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikeve“ të parashikuar nga neni 283/2 i K.Penal.

4.1 Rreth orës 19:30, punonjësit e policisë kanë mbërritur në adresën ku banon shtetasi Kreshnik Halilaj në rrugën “Halit Bega” , Tiranë, ku në ambjentin që është ngjitur me shtëpinë e këtij shtetasi e cila është dyqan me mbishkrimin “Tabachino”, është konstatuar shtetasi Kreshnik Halilaj dhe tre persona të tjerë. Është bërë ndërhyrja mbi bazën e vendimit të Gjykatës duke arrestuar shtetasin Kreshnik Halilaj, si dhe është bërë identifikimi i shtetasve që shoqëronin atë me gjeneralitetet Alfred Gurzi, Ymer Gjeta dhe Robert Bregu.

5. Është ushtruar kontroll në ambjentet e tabakinës , ku në njërin prej raftëve të saj është gjetur një objekt në dukje pistolet me mbishkrimin “BLOË” me numer serial B18Y3-17119275, e cila ka në kreher 7 (shtatë) fishek pa predhë si ato zhurmë imitues. Në vijim të kontrollit në hapësirën që kalohet nga dyqani për në brendësi të banesës në mur ndodhen një aparat matës, si ato të energjisë elektrike, ku mbi të është konstatuar një qese plastike, si ato të cigareve ku brenda saj ka 5 doza të mbeshjtella me qese plastike, të cilat janë të spërdredhuara dhe të

djeguaara në majen e tyre , ku brenda kanë material pluhur me ngjyrë të bardhë të dyshuar si lëndë narkotike e llojit kokainë. Pasi është bërë sekuestrimi i lëndës së dyshuar narkotike e llojit kokainë, ka rezultuar me peshë të pergjithshme 2.2 ( dy pikë dy) gramë.

5.1 Janë pyetur në cilësinë e personit që ka dijani për veprën penale shtetasit Robert Bregu, Ymer Gjeta dhe Alfred Gurzi, të cilët kanë deklaruar se nuk kanë dijani rreth faktit se shtetasi Kreshnik Halilaj shet lëndë narkotike.

5.2 Është pyetur në cilësinë e personit nën hetim shtetasi Kreshnik Halilaj, i cili ka deklaruar se në me lidhje me dozat e kokainës të gjetura në banesë , janë të tijat, i ka për përdorim vetjak dhe se për to, nuk ka dijani asnjë nga familjaret e tij. Ai ka sqaruar se është përdorues i lëndës narkotike të llojit kokainë prej më shumë se 10 vjetësh.

5.3 Gjate kontrollit personal dhe të banesës, shtetasit Kreshnik Halilaj i janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale ndër të tjera dy aparat celular, dy DVR model “HIKVISION” dhe një pistoletë si ato që përdoren me fishek manovër me mbishkrim “BLOË” me numër serial B18Y3-171119275, së bashku me krëhërin me 7 fishekë.

5.4 Nga kqyrja e pamjeve filmike të dy DVR –ve model “HIKVISION”, sipas procesverbalit të datës 13.12.2021 dhe nga kqyrja e të dy aparateve celularë të sekuestruar në vendngjarje të procesverbalit të datës 17.09.2021, nuk janë përfutur të dhëna me interes për hetimin.

5.5 Është administruar **Akt ekspertimi teknik i armës Nr.302, datë 04.08.2021, të sekuestruar shtetasit Kreshnik Halilaj ku është arritur në konkluzionin se: “Pistoleta objekt ekspertimi është e markës “BLOË”, TR 14 Cal .9 mm P.A.K me Nr B18Y3-171119275, është armë zjarri që shërben për “Sinjalizim Akustik”.**

5.6 Në lidhje me armën e zjarrit të sekuestruar, shtetasi Kreshnik Halilaj që shërben për “Sinjalizim Akustik”, ky i fundit dispononte një Fletë –dalje me Nr.144 prot, datë 07.08.2020 të lëshuar nga Komisariati i Policisë Nr 4 Tiranë.

6. Është administruar **Akti i ekspertimit kimik Nr 10774, datë 22.10.2021, në ngarkim të shtetasit Kreshnik Halilaj, ku është arritur në konkluzionin se: “Analiza me GC/MS për materialet te numertuar nga 1-5, objekt ekspertimi tregoi për praninë e kokainës. Peshë pa ambalazh e materialit objekt ekspertimi është 1.873 gramë”.**

6.1 Sipas **Aktit të ekspertimit toksikologjiko-ligjor nr.1714, datë 14.07.2021, është arritur në konkluzionin se: “Në mostrën e urinës te marrë shtetasit Kreshnik Halilaj , mbyllur në kontenier dhe të futur në qese prove me Nr 20000182, u zbulua prania e produkteve të metabolizmit të kokainës (benzoilekgoninë) në organizmin e njeriut”.**

7. Nga analizimi i provave të grumbulluara, sipas prokurorit rezulton se nga ana e të pandehurit Kreshnik Halilaj janë konsumuar elementët e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, më shumë se një herë, parashikuar nga neni 283/2 i K.Penal. Nga hetimi i kryer me metoda speciale për dokumentimin e veprimtarisë kriminale të shtetasit Kreshnik Halilaj, kanë rezultuar të provuara tre raste të shitjes së lëndëve narkotike të llojit kokainë nga ana e këtij shtetasi, ndaj shtetasve Artur Nela, Igli Hida dhe Mariglen Mejdani. Të tre keta shtetas gjate hetimit kanë pranuar se shtetasi Kreshnik Halilaj njihet prej tyre si shitës i lëndëve narkotike të llojit kokainë dhe se secili prej tyre në mënyrë të pavarur, ka blerë kundrejt pagesës nga një dozë të lëndës narkotike të llojit kokainë. Gjithashtu nga hetimi u provua se shtetasi mbante në kundërshtim me ligjin një sasi prej 1.873 grame kokainë. Në këto rrethana rezulton se nga ana e të pandehurit Kreshnik Halilaj janë konsumuar elementët e veprës penale “Prodhim dhe shitje narkotikësh”, parashikuar nga neni 283/2 i K.Penal.

7.1 Këto fakte bazohen dhe rezultojnë të provuara nga: Autorizimet e vëzhgimit dhe procesverbalet e raportet e vëzhgimit; Proçesverbalin e sekuestrimit të sendeve; Proçesverbali i

kontrollit të banesës; Aktet e ekspertimit mjekoligjor e kimik të lëndës; Deklarimet e shtetasve Artur Nela, Igli Hida, Mariglen Mejdani; Deklarimet e të pandehurit Kreshnik Halilaj si dhe në tërësi aktet e procedimit penal nr. 3548, i vitit 2021.

7.2 I pyetur në cilësinë e të pandehurit, shtetasi Kreshnik Halilaj ka deklaruar se e kupton akuzën dhe e pranon atë.

7.3 Në këto kushte, në diskutimin përfundimtar organi i akuzës kërkoi deklarinim fajtor të të pandehurit Kreshnik Halilaj për kryerjen e veprës penale të “*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*”, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal.

## II. Vlerësimi i gjykatës.

### • Në lidhje me përgjegjësinë penale të të pandehurit Kreshnik Halilaj.

8. Gjykata vlerëson të theksojë se ekzistenca e përgjegjësisë penale në aspektin juridik kushtëzohet nga ekzistenca e elementëve të figurës së veprës penale. Në këtë kuptim, në mënyrë që një subjekt të deklarohet fajtor për kryerjen e një vepre penale, për të cilën akuzohet, duhet që gjykata të analizojë respektivisht objektin, anën objektive, subjektin dhe anën subjektive të figurës së veprës penale sipas rrethanave konkrete.

9. Në çështjen objekt gjykimi, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka kërkuar deklarinim fajtor të të pandehurit Kreshnik Halilaj për veprën penale të “*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal. Në këtë nen parashikohet shprehimisht se: “*Shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi, dorëzimi, si dhe mbajtja, përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla, të substancave narkotike dhe psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. Organizimi, drejtimi apo financimi i kësaj veprimtarie, dënohen me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.*”.

**9.1 Në lidhje me objektin e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”.** Objekti i veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283 paragrafi i parë i Kodit Penal mund të indentifikohet si i dyfishtë, në objekt parësor dhe në objekt dytësor. Objekti parësor janë marrëdhëniet juridike të vendosura nga shteti që garantojnë shitjen, blerjen, shpërndarjen transportimin, mbajtjen dhe përdorimin sipas dispozitave ligjore përkatëse të lëndëve narkotike e psikotrope, nga veprime të kundra ligjshme e shoqërisht të rrezikshme, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin e personit, funksionimin normal të veprimtarisë së organeve jetësore të tij. Kjo dispozitë përjashton nga përgjegjësia personale përdoruesit e lëndëve narkotike duke përcaktuar si kritere mbajtjen në doza të vogla, ndërsa përgjigjen penalisht pavarësisht se është përdorim vetjak kur sasia e mbajtur është e madhe. Qëllimi i ligjvënësit në përjashtimin e përdoruesve ka qenë duke i parë ata si viktima të veprës penale dhe jo si subjekte të kryerjes së saj. Ndërsa objekti dytësor i kësaj vepre penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura nga ligji për të garantuar paprekshmërinë e rendit dhe qetësisë publike,



jetës dhe shëndetit të njeriut. Në rastin konkret ky objekt rezultoi të jetë çenuar me veprimet e kundërligjshme (të cilat do të analizohen më poshtë) të të pandehurit Kreshnik Halilaj.

**9.2 Në lidhje me anën objektive të figurës së veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”.** Gjykata thekson se ajo është element i domosdoshëm për përgjegjësinë penale, sepse nëse nuk ka veprim ose mosveprim të dënueshëm nuk ka vepër penale. Askush nuk mund të dënohet për mendimet apo idetë e tij. Në kuptim të nenit 283 të Kodit Penal, legjislatori ka parashikuar se kjo vepër penale mund të kryhet me mënyra të ndryshme si: **përmes shitjes**, ofrimit për shitje, dhënies ose marrjes në çdo formë, transportimit, dërgimit, dorëzimit, mbajtjes, shpërndarjes, apo tregtimit në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tij. Kjo do të thotë se veprimet e mësipërme aktive të subjektit aktiv të veprës penale duhet të jenë në kundërshtim me parashikimet e ligjit që rregullon regjimin juridik të lëndëve narkotike.

9.2.1 Në çështjen konkrete, Gjykata çmon se provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri Kreshnik Halilaj e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Kështu, rezultoi se i pandehuri Kreshnik Halilaj mbante në kundërshtim me ligjin një sasi lënde narkotike të llojit kokainë, e cila ka rezultuar me peshë totale 1.873 gram pa ambalazh. **Akti i ekspertimit kimik Nr. 10774, datë 22.10.2021, ka arritur në konkluzionin se: “Analiza me GC/MS për materialet të numëruar nga 1-5, objekt ekspertimi tregoi për praninë e kokainës. Pësha pa ambalazh e materialit objekt ekspertimi është 1.873 gramë”.**[Sipas Aktit të ekspertimit toksikologjiko-ligjor nr.1714, datë 14.07.2021, është arritur në konkluzionin se: “Në mostrën e urinës të marrë shtetasit Kreshnik Halilaj, mbyllur në kontener dhe të futur në qese prove me Nr 20000182, u zbulua prania e produkteve të metabolizmit të kokainës (benzoilekgoninë) në organizmin e njeriut”. Legjislatori ka përjashtuar nga përgjegjësia penale personat që mbajnë lëndë narkotike apo psikotrope në dozë të vogël dhe për përdorim vetjak, por në rastin konkret ky parashikim nuk gjen zbatim. Gjithashtu Gjykata çmon të theksoj se doza e vogël, në kuptimin ligjor të saj, konsiderohet jo ndarja fizike në disa të tilla, por sasia e lëndës apo substancës narkotike a psikotrope që ajo përmban si e tërë (për më tepër shih Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë Nr. 1 datë 27.03.2008).

Në këtë rast sasia e lëndës nuk mund të konsiderohet e vogël dhe kjo çështje as nuk është vënë në diskutim nga i pandehuri Kreshnik Halilaj.

Gjithashtu, nga hetimi i kryer me metoda speciale për dokumentimin e veprimtarisë kriminale të të pandehurit Kreshnik Halilaj, kanë rezultuar të provuara tre raste të shitjes së lëndëve narkotike të llojit kokainë nga ana e të pandehurit, ndaj shtetasve Artur Nela, Igli Hida dhe Mariglen Mejdani. Kështu, referuar deklarimeve të shtetasve Artur Nela, Igli Hida dhe Mariglen Mejdani, deklarime të cilat kanë marrë vlerën e dëshmisë si rezultat i gjykimit të shkurtuar, ka rezultuar se i pandehuri Kreshnik Halilaj njihet prej tyre si shitës i lëndëve narkotike të llojit kokainë dhe se secili prej tyre në mënyrë të pavarur, ka blerë nga i pandehuri kundrejt pagesës nga një dozë të lëndës narkotike të llojit kokainë.

Duke e parë çështjen në këtë këndvështrim si dhe duke respektuar detyrimet ligjore që rëndojnë mbi përfaqësuesin e akuzës për të vërtetuar akuzën e ngritur ndaj të pandehurit Kreshnik Halilaj, kjo edhe në vështrim të parimeve të përgjithshme të legjislationit procedural penal, Gjykata çmon se, në kuptim të kësaj dispozite të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë (neni 283/2 i Kodit Penal), nga ana e përfaqësuesit të akuzës u vërtetua përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se, nga pikëpamja e faktit, i pandehuri Kreshnik Halilaj ka vepruar më shumë se një herë për, “.....tregtimit, mbajtjen, e substancave narkotike .....”, ndër mënyrat e kryerjes së kësaj vepre penale, në pikëpamje të anës objektive të kësaj figure vepre penale.

**9.3 Në lidhje me anën subjektive të figurës së veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”**, Gjykata vlerëson se ky element i figurës së veprës penale lidhet me qëndrimin psikik që mban personi kundrejt veprës së kryer prej tij. Faji, pa të cilin nuk mund të ketë përgjegjësi penale “nullum crimen, nulla poena sine culpa”, është element i përgjegjesisë penale që parashikohet shprehimisht në nenin 14 të Kodit Penal. Ai përmban në vetvete dy momente: atë intelektual dhe atë që lidhet me vullnetin. Momenti intelektual tregon nëse subjekti nga pikëpamja e ndërgjegjes ka qenë në gjendje të kuptonte karakterin e kundërligjshëm ose shoqërisht të rrezikshëm të veprës, të parashikonte ose jo ardhjen e pasojave të dëmshme, kurse momenti që është i lidhur me vullnetin tregon nëse ai dëshiron ose jo për të kryer një veprim të kundërligjshëm ose shoqërisht të rrezikshëm dhe nëse dëshironte ardhjen e pasojës. Nëpërmjet individualizimit të këtyre dy momenteve, intelektual dhe volutiv, është e mundur të bëhet dallimi i dy formave të fajësisë, të dashjes e të pakujdesisë. Për të qenë para veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, të parashikuar nga neni 283/2 i K.Penal, duhet që i pandehuri të veprojë me dashje. Shkaqet apo motivet që e kanë shtyrë të pandehurin të kryejë këtë veprë penale nuk kanë rëndësi për cilësimin ligjor të veprimeve të të pandehurit, por mbahen parasysht nga Gjykata në caktimin e llojit dhe masës së dënimit. Në rastin konkret, i pandehuri ka vepruar me dashje duke mbajtur në mënyrë të kundërligjshme në dyqanin e tij lënde narkotike të llojit cocainë, me peshë totale prej 1,873 gram pa ambalazh. Gjithashtu rezulton se provuar se i pandehuri u ka shitur shtetasve Artur Nela, Igli Hida dhe Mariglen Mejdani lënde narkotike të llojit kokainë kundrejt pagesës, në varësi të sasisë që ata dëshironin të blenin.

**9.4 Në lidhje me subjektin e veprës penale.** Në rastin konkret, i pandehuri në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë mbi 14 vjeç, dhe rrjedhimisht Gjykata, në vështrim të nenit 12/1 të Kodit Penal, çmon se në drejtim të moshës i pandehuri Kreshnik Halilaj, ka qenë madhor e i përgjegjshëm penalisht në datën e kryerjes së veprës penale objekt gjykimi dhe, si i tillë, ai ka patur moshën për përgjegjësi penale. Gjithashtu, në çështjen objekt gjykimi nuk u provua që i pandehuri të vuajë ngandonjë turbullim psikik ose neuropsikik që ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor dhe për pasojë nuk ka qenë në gjendje të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij dhe as të kuptojë se kryen veprë penale. Përkundrazi me veprimet e tij provohet që ai ka qenë i aftë të posedojë aftësi intelektuale dhe volutive për të kuptuar dhe vlerësuar sjelljen e tij dhe ta kontrollojë atë. Në këto kushte, gjykata vlerëson se i pandehuri është subjekt i përgjegjshëm penalisht.

10. Në referim të analizës së mësipërme, rezulton se janë konsumuar të gjithë elementët e figurës së veprës penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal, e për pasojë gjykata vlerëson se i pandehuri Kreshnik Halilaj duhet të deklarohet fajtor për kryerjen e saj.

- **Në lidhje me caktimin e llojit dhe masës së dënimit.**

11. Dënimi penal përfaqëson shtrëngimin shtetëror që zbatohet ndaj subjekteve të deklaruar fajtor për kryerjen e një veprë penale, duke synuar jo vetëm ndëshkimin, por njëkohësisht edhe edukimin dhe parandalimin e kryerjes së veprave penale përsëri në të ardhmen. Në këtë kuptim, është e domosdoshme që gjykata gjatë caktimit të tij, të udhëhiqet jo vetëm nga parimi i ligjshmërisë dhe domosdoshmërisë së dënimit, por njëkohësisht edhe nga parimi i dobishmërisë

dhe individualizimit të tij. Në vijim të këtij arsytimi, gjykata vlerëson t'i referohet nenit 47 të K. Penal, në analizë të së cilit, kriteret për caktimin e dënimit konsistojnë në:

**i. Rrezikshmërinë e veprës penale.** Përcaktimi i rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale lidhet gjithmonë me natyrën dhe llojin e saj, me masat e dënimit që përcakton neni përkatës, me përhapjen, pasojat që ka sjellë. Këtu, Gjykata thekson se paragrafi i dytë i figurës së veprës penale “*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*” përbën krim, për të cilën ligjvënësi parashikon dënimin me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet, që paraqet rrezikshmëri të lartë shoqërore. Gjykata cmon se kjo vepër penale ka marrë një përhapje shumë të gjerë në komunitetin tonë. Prandaj, në caktimin e dënimit, Gjykata mban parasysh funksionin e parandalimit të përgjithshëm në kryerjen e kësaj veprë penale.

**ii. Rrezikshmërinë e autorit.** Në lidhje me këtë element gjykata duhet të ketë në konsideratë gjendjen sociale, profesionin, arsimimin, gjendjen familjare dhe atë gjyqësore. Në rastin objekt gjykimi, Gjykata në rastin konkret mban parasysh disa fakte. **Së pari:** gjykata mban parasysh personalitetin e të pandehurit, të kaluarën e tij kriminale, e cila nga vërtetimi i gjendjes gjyqësore rezulton i padënuar më parë. **Së dyti,** mban parasysh sjelljen e të pandehurit para dhe pas kryerjes së veprës penale. Kështu i pandehuri që në momentet e para ka shfaqur pendesë për veprimet e kryera. Kjo tregon një sjellje të mirë të autorit pas kryerjes së veprës penale. **Së treti,** gjykata mban parasysh gjendjen familjare të të pandehurit, i cili rezulton të jetë i martuar, kryefamiljar, me një fëmijë të mitur.

**iii. Shkallën e fajit.** Në lidhje me këtë kriter, nga tërësia e të gjithë veprimeve të të pandehurit, Gjykata thekson se ato janë kryer në formën e dashjes direkte, formë e cila përbën edhe shkallën më të lartë të fajit. Kjo për faktin, pasi i pandehuri ka qenë në gjendje të kuptonte karakterin e kundërligjshëm dhe shoqërisht të rrezikshëm të veprës penale “*Prodhim dhe shitje narkotikësh*” dhe me ndërgjegje ka vepruar, duke mbajtur në kundërshtim me ligjin një sasi lënde narkotike të llojit cocaineme peshë totale 1,873 gram pa ambalazh si dhe u ka shitur shetasve Artur Nela, Igli Hida dhe Marigen Mejdani lënde narkotike të llojit kokainë kundrejt pagesës, në varësi të sasisë që ata dëshironin të blenin.

**iv. Në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rënduese.** Në caktimin e masës së dënimit kundër autorit të veprës penale konkrete, gjykata mban parasysh, ndër të tjera, rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat janë faktorë të ndryshëm objektive dhe subjektive që tregojnë për një shkallë rrezikshmërie më të ulët ose më të lartë të veprës dhe të fajtorit. Në çështjen objekt gjykimi lidhur me rrethanat lehtësuese, duke patur parasysh se në referim të nenit 49 të K. Penal ato nuk janë shterruese, gjykata vlerëson të mbajë në konsideratë faktet se: i pandehuri e ka pranuar fajësinë si dhe rezulton të jetë i padënuar më parë. Në lidhje me rrethanat rënduese, gjykata konstaton se nuk ekzistojnë rrethana të tilla.

12. Në referim të analizës së mësipërme, gjykata vlerëson të dënojë të pandehurin Kreshnik Halilaj me 7 (shtatë) vjet burgim për kryerjen e veprës penale “*Prodhim dhe shitje e narkotikëve*”, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal. Në aplikim të nenit 406 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale, ulet 1/3 (një e treta) e dënimit, duke u dënuar përfundimisht i pandehuri Kreshnik Halilaj me 4 (katër) vjet e 8 (tetë) muaj burgim.

- Në lidhje me pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në prove

13. Në zbatim të nenit 59/1 të K. Penal, i cili parashikon se: “Për shkak të rrezikshmërisë së paktë të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, mënyrës së jetesës dhe të nevojave, veçanërisht atyre që lidhen me familjen, shkollimin ose punën, rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, gjykata, kur jep dënim me burg deri në pesë vjet mund të urdhëroj që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale” si dhe nenit 59/3 të K. Penal, i cili parashikon se: “Për dënimet e dhëna deri në dy vjet burgim, të pezulluara nga gjykata, afati i provës është sa dyfishi i kohës së dënimit me burgim të dhënë nga gjykata”, gjykata çmon të pezullojë ekzekutimin e dënimit me burgim ndaj të pandehurit Kreshnik Halilaj, duke e vendosur atë në provë për një afat 4 (katër) vjet, me kusht që gjatë kësaj kohe të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të mos kryejë asnjë veprë tjetër penale.

13.1 Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, si një nga alternativat e këtij lloj dënimi, çmohet i zbatueshëm në rastin në gjykim duke qenë se gjykata arriti në përfundimin se i pandehuri duhet të dënohet përfundimisht me 4 (katër) vjet e 8 (tetë) muaj burgim, duke u përmbushur në këtë mënyrë kushti se masa e dënimit për të cilin mund të aplikohet neni 59 i K. Penal është deri në 5 (pesë) vjet burgim. Po kështu, bazuar në analizën e mësipërme, gjykata vlerëson se si rrezikshmëria e veprës penale, referuar rrethanave konkrete të kryerjes së saj, ashtu edhe rrezikshmëria e vetë të pandehurit është e tillë që të justifikojë zbatimin e nenit 59 të K. Penal. Në këtë qëndrim gjykata mban parasysh gjendjen familjare të të pandehurit, i cili rezultoi të jetë i martuar, me një fëmijë të mitur si dhe faktin që është kryefamiljar, duke qenë në aspektin financiar, një mbështetje e rëndësishme për familjen e tij. Ai është i padënuar më parë. Në vështrim edhe të parimeve kushtetuese dhe të jurisprudencës e teorisë së konsoliduar evropiane, qëllimi më i qenësishëm i dënimit penal dhe synimi final i tij është riedukimi i autorit të veprës penale dhe riintegrimi i tij në shoqëri pas kryerjes së dënimit dhe jo ndëshkimi i tij. Dënimi me burgim duhet jetë një *extrema ratio* në raste të veçanta, atëherë kur nuk mund të zbatohen masa të tjera të përshtatshme. Siç shprehet nga Këshilli i Evropës, burgimi duhet të zbatohet si masë vetëm “kur çdo masë apo sanksion tjetër do të ishin të papërshtatshme për rëndësinë e veprës” dhe duhen bërë përpjekje që të minimizohet përdorimi i masave që e privojnë personin nga liria dhe të zbatohen më shumë të cilat nuk e bëjnë këtë.

13.2 Bazuar në analizën e mësipërme, gjykata përfundimisht vlerëson të pezullojë ekzekutimin e dënimit me burgim ndaj të pandehurit Kreshnik Halilaj, duke e vendosur atë në provë për një afat 4 (katër) vjet, me kusht që gjatë kësaj kohe të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të mos kryejë asnjë veprë tjetër penale.

- **Në lidhje me shpenzimet procedurale**

14. Në bazë të nenit 393/1 dhe 485/3 të K. Pr. Penale shpenzimet procedurale të fazës së hetimit, si dhe shpenzimet gjyqësore i ngarkohen të pandehurit Kreshnik Halilaj.

**PËR KËTO ARSYE:**

Gjykata, bazuar në nenet 190, 379 e vijues, nenet 403, 405, 406, të Kodit të Procedurës Penale dhe nenet 1/c, 47-49, 59 dhe 283/2 të Kodit Penal,

**VENDOSI:**

- |  |
|--|
|  |
|--|
1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Kreshnik Halilaj** për kryerjen e veprës penale të “**Prodhimi dhe shitja e narkotikëve**”, parashikuar nga neni **283/2** i Kodit Penal dhe dënimin e tij në bazë të këtij neni me 7 (shtatë) vjet burgim.
  2. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Kreshnik Halilaj** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 4 (katër) vjet e 8 (tetë) muaj burgim.
  1. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të këtij dënimi dhe vendosja në provë e të pandehurit **Kreshnik Halilaj**, për një afat 4 (katër) vjet, me kusht që gjatë kësaj kohe ai të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës dhe të mos kryejë veprë tjetër penale. Afati i kohës së provës për të pandehurin **Kreshnik Halilaj** fillon nga dita e nesërme e shpalljes së këtij vendimi.
  3. Në bazë të nenit 60.9 të Kodit Penal detyrohet i pandehuri **Kreshnik Halilaj** që gjatë kohës së provës të mos shoqërohet me persona të denuar.
  4. Në bazë të nenit 389 të K.Pr.Penale, urdhërohet heqja e masës së sigurimit “arrest në shtëpi”, caktuar ndaj të pandehurit **Kreshnik Halilaj** me vendimin nr. 1091 Akti, datë 04.07.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndryshuar me vendimin nr. 842 Akti datë 21.09.2021 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lirimi i tij i menjehershëm, nëse nuk mbahet i ndaluar, i arrestuar, apo i denuar për ndonjë veprë tjetër penale.
  5. Bazuar në nenin 190/1 të K.Pr.Penale provat materiale: Dy aparatet e telefonit celular (Nokia me ngjyrë të zezë me numër IMEI: 359146231711720 dhe IMEI 2: 359146232211720 me kartë sim Vodafone me numër 00355693782545; Iphone me ngjyrë të zezë me numër IMEI: 355608700006936); Një pistoletë si ato që përdoren me fishekë manovër, me mbishkrimin Bloë me numër serial B18Y3-17119275, së bashku me krëhërin me 7 fishekë dhe me lejen e lëshuar nga Komisariati Policisë nr. 4 Tiranë; Një DVR e markës “Hikvision” me ngjyrë të zezë, me numër serial D80772145; Një DVR e markës “Hikvision” me ngjyrë të zezë, me numër serial E26426758; 5 (pesë) ora dore të markave të ndryshme (“GOER”; “Yili”; “SERIES6 44MM AL UMINUM; “STAINLESS STEEL CASEBACK; “SËEET DREAM”), sekuestruar të pandehurit Kreshnik Halilaj të kthehen kështu shtetasi, pasi vendimi të marre forme të prera; Shuma prej 8730 Eurosh (të cilat janë prerje: 2 prerje 500, 15 prerje 100; 119 prerje 50; 14 prerje 20) dhe shuma prej 422.800 (katërqind e njëzetë e dymijë e tetëqind) lekë, sekuestruar të pandehurit Kreshnik Halilaj, të kalojnë në favor të shtetit, pasi vendimi të marre forme të prera (si përfitim nga vepra penale); sasia e lëndës narkotike 1,873 gram e llojit kokainë të asgjësohet.
  6. Shpenzimet proceduriale gjatë fazës së hetimeve paraprake si dhe shpenzimet gjyqësore i ngarkohen të pandehurit.
  7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të vendimit.

**U shpall sot në Tiranë, më datë 27.04.2022.**

**GJYQTAR      GJYQTARE      GJYQTAR**

**Albert MEÇA**

**Armela HASANTARI Artan GJERMËNI**

**SEKRETARE**

**Berzana ÇOBO**

**Shpenzime gjyqesore**

Shpenzime te prokurorise 40.000 leke

**Shpenzime ne séance paraprake dhe themel**

Njoftime 450 leke